

**ALBANA MEMA****ZGJEDHJET E PARA POLITIKE NË SHQIPËRI  
(PRILL 1921)****Debati publik në prag të zgjedhjeve të vitit 1921**

Zgjedhjet janë institucioni themelor, që formëson regjimin politik si dhe krijon premisa për krijimin e një pjese të rëndësishme të institucioneve shtetërore. Mënyra si ato zhvillohen, ndikon shumë në karakterin e institucioneve politike që krijohen pas tyre.

Pas Kongresit të Lushnjës, në Shqipëri, u zhvillua një debat i trazuar dhe i ashpër mbi çështjet themelore politike, ekonomike dhe sociale. Po merre formë një kulturë politike edhe pse akoma në një fazë shumë të hershme dhe fillestare.<sup>1</sup>

Debati mbi organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, vazhdoi gjatë gjithë kësaj periudhe. Analistë dhe politikanë të kohës, dhanë idetë e tyre, në lidhje me mënyrën se si duheshin të zhvilloheshin zgjedhjet në Shqipëri. Një analizë interesante për këtë çështje, bënte në nëntor të vitit 1920, Ali Këlcyra, në gazetën “Mbrojtja Kombëtare”, botuar në Vlorë. Në lidhje me sistemin që duhej përdorur në zgjedhjet e reja që do të zhvilloheshin në vend, ai shprehej se, në formimin e ligjit të zgjedhjeve, qeveria dhe legjislatorët duhet të merrnin parasysh disa pika kryesore, për të cilat jepte përcaktime të detajuara.<sup>2</sup> Këto ishin mendime dhe pikëpamje mjaft demokratike dhe të dobishme për kohën, por që ishte e vështirë të gjenin një mjedis të gjerë mbështetës.

Për mënyrën e zgjedhjes së deputetëve në vitin 1921, janë dhënë mendime të shumta në shtypin shqiptar të kohës. Sipas një shkrimi në gazetën e Shkodrës, “Besa Shqyptare”, përveç domosdoshmërisë së zgjedhjeve, analizohej edhe rëndësia e madhe që kishte deputeti që do të

---

<sup>1</sup> Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, Tiranë: Albin, 2003, f. 51.

<sup>2</sup> Ali Këlcyra, “Nomi Sgijjedhjevet”, *Mbrojtja Kombëtare*, Vlorë, nr. 6, 18 nanduer 1920.

zgjidhej. Ajo nënvizonte se deputeti ishte përfaqësuesi i disa mijëra vetëve që e kishin zgjedhur për të mbrojtur të drejtat e tyre, së bashku me ato të të gjithë shtetit. Ai përbënte fuqinë ligjore me të cilën vepronte për të mirën e përgjithshme të vendit. Deputetët të gjithë së bashku, ose me shumicë zërash, si përfaqësuesit e popullit, u jepnin besimin ose mosbesimin ministrave dhe me fuqinë e fjalës së tyre, rrëzonin ose mbështesnin ministrin, i cili merrte në dorë sundimin qeveritar. Parlamenti, i përbërë nga deputetët, ishte i vetmi organ që mund të caktonte ligjet e nevojshme për ndryshimet e rregullimet e shtetit dhe çfarë vendosej prej tij, duhet të ndiqej nga të tjerët. Pra, sipas saj, deputetëve duhej t'u jepej rëndësia e nevojshme dhe nuk duhej të zgjidheshin sipas dëshirës së partive, të njërit apo tjetrit krahe.

Duke portretizuar figurën e deputetit, gazeta shkruante se, ai duhet të ishte njeri i zgjuar, i kuptueshëm, i ditur e i ndershëm karshi të tjerëve, pasi do të përfaqësonte një grup shtetasish, që do të mbështesnin shpresën e tyre mbi të. Deputetët duhet të ishin nga të gjitha degët më të nevojshme për jetën e një populli, duhet të ishin dijetarë, shkrimtarë, juristë, tregtarë etj., që të mund të jepnin shpjegimet e nevojshme, të mbronin shtetin nga rreziqet dhe të sqaronin zakonet e dëshirat e krahinave, prej të cilave ishin zgjedhur. “Duke vepruar në këtë mënyrë, shkruante gazeta, do të kemi një Parlament që do të jetë nderi e fuqija e Shtetit t’onë.”<sup>3</sup>

Në prag të zgjedhjeve lindën kundërshtitë e para, sidomos për çështjen nëse zgjedhjet do të zhvilloheshin për Asamblenë Kushtetuese, sikurse ishte parashikuar në Statutin e Lushnjës, apo për ripërtëritjen e parlamentit ekzistues.<sup>4</sup> Ky debat e ndau në dysh lidërsipin politik të kohës, një pjesë prej tyre ishin për zgjedhje të Asamblesë dhe të tjerë për zgjedhje parlamentare. Me gjithë dëshirat e disa të rinjve në Përmet, Korçë e Vlorë për zgjedhjen e një Asambleje Kushtetuese, rrethanat e asaj kohe impononin vetëm zgjedhje parlamentare. Për Sejfi Vllamasin, eksponent i rëndësishëm i politikës shqiptare, zgjedhjet do të duhej të bëheshin indirekt

<sup>3</sup> “Zgjedhja e deputetvet”, *Besa shqiptare*, Shkodër, nr. 1, 8 fruer 1921.

<sup>4</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, v. III (Periudha e Pavarësisë, 28 nëntor 1912-7 prill 1939), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 177.

në bazë të një ligji të posaçëm, domethënë me zgjedhës të dytë, mbasi në ato kushte zgjedhjet direkte qenë të pamundura.<sup>5</sup>

Legata italiane në Durrës pasqyronte objektivat e grupeve që mbështesnin zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese si dhe shtrirjen e tyre. Ajo theksonte se, në vend ishte mjaft e fuqishme rryma që donte të paraprinte me mbledhjen e një asambleje kombëtare me karakter kushtetues, para se të mbërrihej në zgjedhjet për parlamentin. Sipas kësaj rryme, asambleja vetë duhej të rishqyronte programin e Lushnjës, ta plotësonte, të përcaktonte atributet e organeve të ndryshme qeveritare dhe të merrte masa paraprake për një ndryshim të mundshëm të përbërjes aktuale të Këshillit të Lartë. Përfaqësues të zëshëm të saj ishin: Mustafa Kruja apo drejtuesit e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe duket se kishte mbështetje edhe në provincën e Shkodrës. Në jug ajo kryesohej nga Myfid Libohova dhe nga elementë ortodoksë të provincave të Gjirokastrës dhe Korçës. Mendimi i krerëve katolikë ende nuk ishte përvijuar qartë. Qëllimi i mësipërm i kundërvihej vullnetit të vendosur të Kabinetit dhe të shumicës së anëtarëve të Regjencës. Vetëm ndonjë senator mund të ishte përkrahës i tij.<sup>6</sup>

Përfaqësia italiane vërente se me projektin e ri për organizimin elektoral politik synohej që, përmes zgjedhjeve të parlamentit, të arrihej një bazë më e gjerë numerike për krijimin e kabinetit qeveritar. Ishte parashikuar rritja në rreth 80 e numrit të deputetëve, nga 37 që ishte aktualisht. Në këtë mënyrë do të eliminohej përcaktimi i adoptuar nga Kuvendi i Lushnjës për të zgjedhur elementët e kabinetit jashtë parlamentit.<sup>7</sup>

Në debatin e shumëpërfolur, në këtë periudhë, nëse Shqipëria duhet të bënte zgjedhje për një parlament të ri, apo për një Asamble Kushtetuese, u angazhua edhe shtypi. “Gazeta e Korçës”, e pasqyronte shumë drejt, ngërçin kushtetues të krijuar kur shkruante: “Kongresi

---

<sup>5</sup> Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, përgatitur për botim nga Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000, f. 246.

<sup>6</sup> *Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri* (ASD MAE), Roma (më tej: *AMAE*, Roma), Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 687, fl. 04623-04624. Telegram postar i legatës italiane në Durrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, Durrës, 3 dhjetor 1920.

<sup>7</sup> *Po aty*, fl. 04625-04626. Telegram postar i legatës italiane në Durrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, Durrës, 8 dhjetor 1920.

Kombëtar i Lushnjës vendosi që: derisa të caktohen kufijtë e Shqipërisë të mos bëhen zgjedhje të reja parlamentare. Zgjedhjet që kërkon të bëjë sot qeveria për një Parlament si të sotmin, janë jashtë rregullave të Statutit të Lushnjës, me të cilin qeveriset shteti ynë. Kështu që, për të ndryshuar apo për të rrezuar Kongresin e Lushnjës, duhet të bëjmë prapë një Kongres të tillë, ose të bëjmë zgjedhje vetëm për një Asamble Nacionale. Kabineti i Iliaz Vrionit duhet të marrë parasysh dëshirën e popullit, i cili është për zgjedhjen e një Asambleje Nacionale dhe faktin se vetëm një Asamble Nacionale mund të bëjë reformat në vend”.<sup>8</sup> Po në faqet e kësaj gazete, Selim Mborja shkruante se, kabineti i formuar nën kryesinë e Iliaz Vrionit në programin e tij pranonte zgjedhjet parlamentare, se e quante të rrezikshme Asamblesë Nacionale dhe për këtë qëllim kishte vendosur ndalimin e çdo lloji mbledhjeje popullore që lidhej me kërkimin e Asamblesë.<sup>9</sup>

Interesant dhe me shumë rëndësi në këtë artikull është fakti se Ahmet Zogu që në fillim ishte për thirrjen e Asamblesë Kushtetuese dhe për këtë arsye, Këshilli i lartë që ishte kundër saj, e kishte mënjeluar atë nga posti i kryeministrit. Saktësia e këtij pohimi duhet vërtetuar edhe nga burime të tjera, të cilat ne nuk i ndeshëm në hulumtimin që kryem.

Sipas profesor Luan Omarit, konfliktet në gjirin e Këshillit Kombëtar si edhe ndërmjet tij dhe qeverisë, pasqyrojnë ballafaqimin e dy rrymave politike, progresiste e konservatore dhe epërsinë e kësaj të fundit. Ky ballafaqim u bë edhe më i ashpër pas zgjedhjeve, që nisën nga fillimi i vitit 1921 dhe përfunduan në pranverë.<sup>10</sup> Në të vërtetë, nuk mund të flitej, në këtë kohë, për ndarje të forcave në progresiste e konservatore brenda Parlamentit Shqiptar. Ky është një konkluzion i sforcuar dhe i paargumentuar.

Në të dy grupet kishte deputetë me pikëpamje progresive ose konservatore. Aq më pak, mund të flitet për epërsi të njërës palë mbi tjetrën. “Partia Popullore” u krijua në pjesën më të madhe nga ishorganizata “Krahu Kombëtar”, që ndryshe njihet me emrin “Klika”. Pas Qazim Kokoshit, kryetar i kësaj partie ishte Fan Noli, pastaj Sejfi Vllamasi, Bedri Pejani dhe më pas Ahmet Zogu. Partia përfaqësonte

<sup>8</sup> “Vetëm Asamble Nacionale”, *Gazeta e Korçës*, Korçë, nr. 48, 4 dhjetor 1920.

<sup>9</sup> Selim Mborja, “Dëshira është për Asamble Nacionale”, *po aty*, nr. 55, 25 dhjetor 1920.

<sup>10</sup> Luan Omari, *Sistemi Parlamentar*, Tiranë: Elena Gjika, 2004, f. 164-165.

mendimin konservator dhe atë liberal. Në shtator 1923, me largimin e mjaft figurave dikur kryesore të saj, “Partia Popullore” ishte tërësisht në drejtim të Ahmet Zogut. Ndërsa “Partia Përparimtare” e krijuar pak ditë më vonë, përfshinte në gjirin e saj klasën e lartë të pronarëve të mëdhenj si Shefqet Vërlacin e Iljaz Vrionin, Mehdi Frashërin etj., si dhe elementë kosovarë që vinin nga Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” si Hoxha Kadriu, (që ishte dhe kryetar i partisë), Hasan Prishtina, Bajram Curri etj.<sup>11</sup> Edhe studiuesi Mousset vëren se të dy partitë shqiptare, e quanin veten si parti nacionaliste dhe shpallnin se ishin të vendosura të mos e ngatërronin fenë me mosmarrëveshjet dhe grindjet e tyre. Këto dy parti, përfshinin në radhët e tyre deputetë demokratë, por edhe bejlerë.<sup>12</sup>

Edhe më pas, grupimet qeveritare konsiderohen konservatore, kurse ato opozitare paraqiten si grupime më demokratike dhe liberal-demokrate. Cilësimet nuk bazohen aq në ndonjë analizë të programit të tyre, por më tepër në tiparet kryesore të liderit politik, gjë që i bën ato formale dhe të dyshimta. Ky është një tjetër tipar, që përforcon idenë se, ashtu si në vendet e tjera ballkanike, edhe në Shqipëri, partitë politike në fillimet e tyre u ngjajnë grupimeve të ngritura dhe të organizuara në formë klanesh, midis grupeve dhe personave me peshë në shoqërinë politike dhe në pushtetin ekonomik të vendit.<sup>13</sup>

### **Komentet mbi ligjin e parë të zgjedhjeve**

Një ndër iniciativat më serioze për rregullimin e një procesi zgjedhor, ishte akti i qeverisë së Iliaz Vrionit, e cila më 5 dhjetor, përgatiti dhe shpalli “Ligjin për Zgjedhjet e Deputetëve në Këshillin Kombëtar”, gjë që përbënte një hap të rëndësishëm për ngritjen e institucioneve demokratike. Më 14 dhjetor 1920, Këshilli i Naltë, dekretoi projektligjin për zgjedhjen e deputetëve. Ky ligj i rëndësishëm, për ecurinë e mëtejshme në drejtim të kushtetutshmërisë së institucioneve

---

<sup>11</sup> Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë: 55, 2006, f. 131-133.

<sup>12</sup> Albert Mousset, *Shqipëria përballë Evropës*, Tiranë: Dituria, 2004, f. 47-48.

<sup>13</sup> Afrim Krasniqi, *Partitë Politike në Shqipëri 1920-2006*, Tiranë: Edlor, 2006, f. 50-54.

kombëtare, nuk arriti të diskutohej në parlament, pasi Këshilli Kombëtar, në këtë kohë, ishte vetëshpërndarë.<sup>14</sup>

Sipas ligjit, zgjedhjet do të bëheshin me votim të tërthortë dyshkallësh. Për çdo 500 veta, do të dilte një zgjedhës i dytë dhe prej tyre, do të zgjidhej një deputet për 12.000 banorë. Të drejtë vote kishin meshkujt në moshën 20 vjeç e lart. Zgjedhësit e dytë, duhej të kishin mbushur 25 vjeç, ndërsa deputetët 30 vjeç dhe duhej të dinin gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur. Ky ligj i përjashtonte gratë nga e drejta e votës.<sup>15</sup>

Ligji i zgjedhjeve<sup>16</sup> u sulmua ashpër nga opozita e kohës, që e cilësoi atë, jodemokratik. Por, në këtë rast, duhet pasur parasysh se, ligji i përshtatej kushteve dhe mundësive në të cilat gjendej shoqëria shqiptare, në atë kohë. Madje, siç do ta provonte koha, edhe vetë opozita që e kritikoi shumë këtë ligj, kur erdhi në pushtet, nuk ishte në gjendje të bënte një ligj tjetër zgjedhor, por, adoptoi ligjin e mëparshëm. Gjendja politike, arsimore, ekonomike dhe struktura shoqërore e shoqërisë shqiptare, ishin në një nivel të tillë, sa që krijonin mundësi dhe shanse tepër të kufizuara për realizimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta, të cilat të ishin të pranueshme për palët dhe njëkohësisht, të prodhonin institucione legjitime demokratike dhe stabilitet qeverisës për vendin.

Në një vend si Shqipëria, ku nuk kishte një shtyp të zhvilluar dhe ku një shumicë e zgjedhësve ishte analfabete, zgjedhjet vareshin gjithmonë nga një numër i vogël individësh me ndikim. Rrjedhimisht, betejat politike

<sup>14</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 146, Viti (më tej: V.) 1920, Dosja (më tej: D.) 1, fl. 55. Deklarata e anëtarëve të Këshillit Kombëtar drejtuar katundarive mbi pushimin e parlamentit deri më 20 dhjetor 1920.

“Para dorëheqjes së Delvinës, kundërshtarët ishin munduar ta rrëzonin qeverinë me anë të Senatit, por për ta paralizuar planin e tyre, senatorët e Korçës, Dibrës, Matit, Elbasanit dhe një i Shkodrës bënë obstrukcion. Kështu që nuk arriti të formohej shumica legale për hapjen e mbledhjes së Senatit dhe plani i tyre dështoi. Në këtë situatë, senatorët e tjerë shkuan për pushime, deri më 20 dhjetor 1920, me konditë që, në rast se nuk do të formohej shumica në Senat, senatorët do të konsideroheshin dorëheqës. Shumica nuk u formua dhe senatorët u quajtën të dorëhequr”.

<sup>15</sup> Fatmira Musaj, *Gruaja në Shqipëri (1912-1939)*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2002, f. 64.

<sup>16</sup> *AQSH*, F. 146, V. 1920, D. 2, fl. 28-34. “Ligji për zgjedhjet e deputetëve, Tiranë, 5 dhjetor 1920”, Shkodër: Shtypshkronja Nikaj, 1920.

ishin pothuajse gjithmonë, rivalitete personale, të cilat, shpesh, kishin gjasa të degjeneronin në konflikte të armatosura.

Pushteti i politikanit, matej, jo aq me numrin e zgjedhësve të tij, as me idetë apo performancën në menaxhimin e shtetit dhe të institucioneve kombëtare, se sa me numrin e njerëzve të armatosur që kishte në dispozicion. Me mbështetjen e tyre, ai ishte në gjendje t'i impononte vullnetin e tij një qeverie, që kishte burime shumë të kufizuara. Karakteri dhe rëndësia e këtyre betejave, shpesh u paraqit keq në atë kohë nga propaganda e huaj.<sup>17</sup> Kjo antropologji e shoqërisë dhe klasës së saj drejtuese, ndikonte fuqishëm në procesin e krijimit dhe konsolidimit të institucioneve, duke e bërë atë të paqëndrueshëm, të vështirë dhe jo efikas.

Pas miratimit të ligjit zgjedhor u zhvillua një debat e diskutim i gjerë në qarqet politike dhe në mendimin juridik shqiptar. Ai pasqyrohej në shtypin e kohës, por, njëkohësisht, zinte një vend të veçantë në punimet e para të shkencës juridike të Shqipërisë, për kushtetuimin e shtetit, sipas parimeve të njohura ndërkombëtare.

Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri përkonin me momentin, kur e drejta e zgjedhjeve po i nënshtrohej reformave të rëndësishme që synonin vendosjen e votimit të përgjithshëm në një varg shtetesh. Debatu për të drejtën e zgjedhjeve, në opinionin politik shqiptar, mori përmasa të konsiderueshme edhe si rezultat i afirmimit të pluralizmit në jetën politike të kohës. Në këtë kohë në Këshillin Kombëtar (Senat) po krijohesh një opozitë gjithmonë e më e konsoliduar, edhe pse nuk u arrit të vendosej institucionalizimi i saj.

Edhe mendimi konstitucional shqiptar për zgjedhjet e lira po fillonte të përpunohej. Në vitin 1920, Kristo Floqi botoi veprën “E drejta themelore”, me të cilën bënte një përpjekje serioze për të ndihmuar në ndërtimin e shtetit të ri shqiptar, sipas parimeve demokratike të konstitucionalizmit. Një natyrë tjetër kishte botimi “E drejta konstitucionale” i Stavro Vinjaut, botim i cili trajtonte të drejtën konstitucionale shqiptare. Ai thellohej më tepër në parimet e përgjithshme të konstitucionalizmit, të cilat, trajtoheshin të konkretizuara me praktikën e kushtetimit të shtetit të ri shqiptar.<sup>18</sup>

<sup>17</sup> Joseph Swire, *Shqipëria, ngritja e njëmbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 310-311.

<sup>18</sup> Aurela Anastasi, *Historia e të Drejtës Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Tiranë: Pegi, 2007, f. 91-92.

Zgjedhjet e para, sado që u mbajtën në një kohë tepër të papërshtatshme për Shqipërinë,<sup>19</sup> do të krijonin parlamentin e parë të vërtetë shqiptar, të dalë nga zgjedhje të lira politike. Por, klasa politike shqiptare ende nuk e kishte bërë të sajën këtë ligj themelor të qeverisjes demokratike. Ajo ishte larg shpirtit dhe frymës së zhvillimit të debatit dhe luftës politike brenda suazave të parlamentit dhe kufijve të normave kushtetuese.

Në prag të ballafaqimit të parë elektoral, konstatohet një zhvillim i vrullshëm politik, formësohen grupimet e para politike e afirmohet një shtyp relativisht cilësor, nëpërmjet të cilit, shpalosen ide e platforma politike. Ky hap cilësor politik, vinte pas krijimit të një sigurie të brendshme e nga përpjekjet për të vënë në jetë filozofinë politike të Kongresit të Lushnjës. Në këto kushte, u intensifikuan përpjekjet për mbajtjen e një procesi zgjedhor, që për ato kushte ishte një zhvillim i rëndësishëm. Përveç të tjerash, kjo i jepte Shqipërisë dhe një imazh pozitiv në sytë e perëndimorëve skeptikë, sikundër i shërbente politikës shqiptare, pasi konkurrenca elektorale, do të çonte në një ballafaqim ideor ndërmjet rrymave politike. Zgjedhjet e reja për Parlamentin Shqiptar u dhanë mundësinë forcave politike, të bënin për herë të parë, një fushatë konkurruese.

### **Grupet kryesore politike pjesëmarrëse në zgjedhje**

Pikërisht në momentet kur qeveria e kryesuar nga Sulejman Delvina sapo kishte rënë, në një raport të Konsullatës së Përgjithshme të Ministrisë Italiane në Janinë, mbi “gjendjen politiko-ushtarake në Shqipëri dhe në Epir”, pasqyrohej ekzistenca e pesë partive (grupimeve)

---

<sup>19</sup> Vendi u detyrua të shkonte në zgjedhje, në një moment të papërshtatshëm, si në planin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në planin e brendshëm, sepse u shpërbë para kohe koalicioni i krijuar në Kongresin e Lushnjës, çka do të kishte pasoja negative për procesin e afirmimit të shtetit të ri, duke krijuar terrenin për diversitetin dhe konfliktin politik, i cili nuk do të vononte të shfaqej rrezikshëm. Në planin ndërkombëtar, pasi zhvilloheshin zgjedhje, kur statusi e kufijtë nuk ishin caktuar dhe shteti shqiptar nuk ishte njohur si subjekt ndërkombëtar. Zgjedhjet në këto rrethana krijojnë shanse për shtetet fqinjë, kundërshtarë të pavarësisë së Shqipërisë, që të ndërhyjnë dhe të destabilizojnë vendin. Këto veprime nuk munguan të shfaqeshin, duke krijuar vështirësi dhe rreziqe të shumta.



kryesore, të përcaktuara si: Partia e Qeverisë së Tiranës, Partia e Mufid Bej Libohovës, që prirrej ndaj Italisë, Partia e Esadistëve, Partia e ortodoksëve proshqiptarë dhe Partia e ortodoksëve progrekë. Në raport partia e parë, ajo e Qeverisë së Tiranës, veçohet për “prirjet e saj favorizuese ndaj ‘xhonturqve’ dhe përfshinte elementë të shumtë nacionalistë të papajtueshëm”.<sup>20</sup> Por, në vijim ndodhi një proces rigrupimi i forcave politike dhe u shfaqën dy partitë kryesore: “Partia Popullore” dhe “Partia Progressive”.

Nga pikëpamja politike, në këto zgjedhje, si forcë e organizuar politike mund të konsiderohej “Krahu Kombëtar”, i cili kishte si synim zgjedhjen për deputetë të personave “me parime politike të Kongresit të Lushnjës”, kundër elementit proitalian.<sup>21</sup> Kjo organizatë u paraqit në zgjedhje si boshti themelor i grupimit politik që quhej “Partia Popullore”. Në kontekstin shqiptar, organizimi i kësaj force politike nacionaliste, ishte dëshmi e fuqizimit të elitës politike me tipare kombëtare. Shtresa nacionaliste shqiptare, kishte filluar një veprimtari të ngjeshur politike në Shqipëri pas vitit 1908. Pas Revolucionit Xhonturk ajo u angazhua në lëvizjen kombëtare dhe atë shtetformuese. Kjo shtresë, për shkak të kontakteve, të zhvillimeve politike në Perandorinë Osmane në shpërbërje e sipër, u angazhua në lëvizjen që solli Shpalljen e Pavarësisë. Më tej konservatorët ishin shtresa mbizotëruese në zhvillimet politike si në qeverinë e Vidit, ashtu edhe përgjatë Luftës së Parë Botërore.

Ky grupim, pati një rol të spikatur në Kongresin e Lushnjës. Eqrem Bej Vlora, një ndër intelektualët kryesorë të kësaj shtrese, si organizatorë kryesorë të kongresit rreshton një sërë bejlerësh që patën një kontribut të madh në dobi të çështjes kombëtare. Prej vitit 1920 e deri më 1924, konservatorët shqiptarë sunduan politikisht Shqipërinë me një mazhorancë relativisht të qëndrueshme.<sup>22</sup> Ndër personalitetet konservatore veçojmë Ahmet Zogun, Shefqet Vërlacin, Iliaz Bej Vrionin,

---

<sup>20</sup> AMAE, Roma, Serie Politica 1919-1930, Albania, Pacco 687, fl. 04575-04579. Raport i Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Janinë drejtuar Shkëlqesisë së Tij, Senatorit Kont Karlo Sforca, ministër i Punëve të Jashme, Romë, mbi gjendjen politikoshtarake në Shqipëri dhe në Epir, Janinë, 15 tetor 1920.

<sup>21</sup> K. Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar...*, f. 127; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 246.

<sup>22</sup> Eqrem Bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2003, f. 492.

Xhafer Bej Ypin e shumë të tjerë, që fatet politike i lidhën me shtresën konservatore. Ndërkohë, të gjithë kryeministrat e zgjedhur me procedura të rregullta parlamentare, i përkisnin, gjithashtu, kësaj shtrese. Përjashtim bënin Qazim Koculi e Hasan Prishtina, zgjedhja e të cilëve, u imponua si pasojë e një lëvizjeje antiqeveritare e antiligjore, njëherësh, në dhjetor të vitit 1921.<sup>23</sup>

Por, kjo nuk do të thotë se në këtë shtresë, të gjithë mbështetën çështjen kombëtare. Ka pasur edhe bejlerë që iu kundërvunë në raste të veçanta dhe për arsye të ndryshme, procesit historik të ndërtimit dhe konsolidimit të shtetit kombëtar shqiptar. Në tentativat e tyre për të sunduar Shqipërinë edhe shtresa e bejlerëve pati disa herë radhazi çarje mes saj. Siparin e përplasjeve e hapi Esat Toptani, i cili, në përpjekjet për të marrë pushtetin më 1920, u përpoq që t'i kundërvihej shumicës së patriotëve. Disa bejlerë e çifligarë të Shqipërisë së Mesme si: Fuat Bej Toptani, Ymer Bej Shijaku e Veli Bej Kruja, ishin të pakënaqur nga pozita që zunë në pushtetin politik pas Kongresit të Lushnjës<sup>24</sup> dhe përgjithësisht luajtën një rol pengues në procesin e konsolidimit të shtetit shqiptar.

Konservatorët u përpoqën të konsolidojnë pozitat e tyre politike, por, njëkohësisht në vitet 1920-1924, ishin faktori më i rëndësishëm politik, për konsolidimin e shtetit shqiptar dhe ndërtimin e institucioneve politike kombëtare. Nga ana tjetër, duke qenë fuqia kryesore politike, ata kishin edhe një pjesë të konsiderueshme të përgjegjësisë për dështimet e kësaj periudhe.

Në këto zgjedhje, “Partia Popullore” u paraqit si subjekt elektoral me një program të hartuar mjaft mirë.<sup>25</sup> Në të njëjtën kohë, një grup deputetësh që iu kundërvu Fan Nolit dhe Ahmet Zogut, krijuan një forcë të re politike, e quajtur “Partia Përparimtare” (demokratike) Shqiptare. Por, “Partia Popullore” dhe “Partia Përparimtare” nuk u ndërtuan dhe nuk funksionuan si parti, as në strukturë dhe as në veprimtarinë e tyre. Asnjëra prej tyre nuk arriti të ndërtonte struktura parlamentare dhe të

<sup>23</sup> *The National Archives*, London (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/7330, fl. 581-586. Telegram i Heathcote Smith për Curzon, mbi situatën politike në vend, 18 janar 1922.

<sup>24</sup> Kaliopi Naska, *Këshilli Kombëtar 1920 (Parlamenti i parë shqiptar)*, botim i drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, Tiranë: 2000, f. 89.

<sup>25</sup> “Partia Popullore”, *Statut e Rregullore*, Vlorë: J. Direttore, 1921.

realizonte një proces zgjedhjesh brenda vetes. Ajo që formonte identitetin e tyre si forca politike, ishte identifikimi me emrat e drejtuesve të tyre.

Pas përfundimit të zgjedhjeve të para politike në Shqipëri, do të dilte një Këshill i ri Kombëtar, i përbërë nga 77 deputetë (anëtari i 78-të do të ishte Fan Noli, i emëruar nga shoqëria “Vatra” në SHBA). Mandati i Këshillit të ri ishte dyvjeçar (1921-1923) dhe për herë të parë, të gjitha krahinat e vendit do të kishin mundësi të zgjidhnin lirshëm përfaqësuesit e tyre, pa diktat nga qeveria.<sup>26</sup> Ballafaqimi elektoral u përqendrua kështu tek dy grupimet politike kryesore: “Popullorët” dhe “Përparimtarët”, të cilët aspironin të siguronin mandatet e nevojshme për të ngritur qeverinë.

### **Qëndrimi i qeverisë ndaj zgjedhjeve**

Qeveria u angazhua në marrjen e masave që zgjedhjet e vitit 1921 të zhvilloheshin në kushte normale. Për këtë arsye ajo u dërgoi një qarkore prefekturave, në të cilën urdhëronte administratën dhe ushtrinë të mos ndërhyjnë në procesin zgjedhor.<sup>27</sup>

Një problem delikat në këto zgjedhje ishte çështja e përfaqësimit politik në parlament, në raport me përkatësitë fetare. Shumica e deputetëve ishin të vendosur që të bëhej gjithçka, që të ruhej uniteti kombëtar në këtë fazë të parë, të vështirë, të konsolidimit të shtetit shqiptar dhe përfaqësimi në parlament, të mos ngrihej mbi kritere të raporteve të besimeve fetare në popullsinë e vendit. Ata afirmuan parimin mbi laicitetin e institucioneve shqiptare.

Në këtë periudhë që me Senatin e dalë nga Kongresi i Lushnjës dhe më tej me Parlamentin e Parë Shqiptar të dalë nga zgjedhjet e vitit 1921, u respektua me vendosmëri parimi i ruajtjes së ekuilibrave fetare në përbërjen e tij, por jo si një akt kushtetues i shkruar. Parimi themelor, i këtij kodi të pashkruar, ishte pjesëmarrja e shqiptarëve të krishterë gjerësisht në institucionet kombëtare edhe në një shkallë më të lartë, se sa pesha specifike që ata kishin në popullsinë shqiptare. Kjo i ka shërbyer procesit të konsolidimit të institucioneve kombëtare dhe fuqizimit të unitetit kombëtar. Por, nga ana tjetër, nga të gjithë shqiptarët, u refuzua

<sup>26</sup> A. Krasniqi, *Partitë Politike në Shqipëri...*, f. 55.

<sup>27</sup> *AQSH*, F. 35, V. 1921, D. 36/4, fl. 919. Letër e Mihal Turtullit, për Mid'hat Frashërin, Tiranë, 21 janar 1921.

me vendosmëri, vendosja e përqindjeve dhe numrave fikse të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së popullsisë së besimeve të ndryshme në institucionet kombëtare dhe lokale, si dhe u refuzua dhe u kundërshtua me forcë çdo lloj ndërhyrje e huaj në këtë drejtim. Kjo ka qenë rruga më e drejtë, në ato situata specifike, në të cilat ndodhej kombi shqiptar, në procesin e vështirë të formimit të shtetit të tij kombëtar.

Kjo strategji dhe ideologji politike në sendërtimin e institucioneve kombëtare ishte zgjidhja më adekuate dhe afatgjatë për ndërtimin e një shteti kombëtar unik me frymë perëndimore, pa tronditur paqen sociale dhe duke sjellë gradualisht në perspektivë, afrimin e të gjithë elementëve e grupeve social-fetare të popullsisë shqiptare. Kjo është një karakteristikë e përbërjes së institucioneve themelore politike të shtetit shqiptar të kësaj kohe dhe për këtë, themeluesit e këtij shteti, me gjithë dobësitë e tjera që shfaqën gjatë sendërtimit të tij, meritojnë një mirënjohje të jashtëzakonshme.

Mirëpo, nga ana tjetër, qeveria e kryesuar nga I. Vrioni ishte e ndërgjegjshme se, në popullsinë e vendit, kishte ende ndjeshmëri për përfaqësimin në institucione sipas përkatësisë fetare dhe aq më tepër, këtë fakt përpiqeshin ta shfrytëzonin shtetet fqinje, për të thelluar më tej përçarjet dhe për të destabilizuar shtetin shqiptar. Në këto kushte, qeveria Vrioni vendosi që të ruheshin raportet fetare të përfaqësimit të popullsisë në parlament, por, duke i rregulluar ato kurdoherë në favor të grupeve fetare, që ishin më të vogla në numër. Kjo ishte një zgjidhje e zgjuar dhe me efekte praktike pozitive, në konsolidimin e shtetit, në këtë fazë të parë të vështirë, të ndërtimit të tij.

### **Tendenca kantonale gjatë zgjedhjeve**

Gjatë fushatës së zgjedhjeve, u shfaqën edhe disa tendenca kantonale si në jug, ashtu dhe në veri, respektivisht në Korçë e Shkodër,<sup>28</sup> të cilat iu drejtuan me kërkesat e tyre qeverisë. Qeveria Vrioni, i hodhi poshtë këto kërkesa, ndërkohë që situata u bë problematike, sidomos në Shkodër, për sa i përket përfaqësimit në raport me përkatësinë fetare. Kështu, me t'u

<sup>28</sup> *Po aty*, F. 146, V. 1921, D. 2, fl. 61. Deklaratë e përfaqësuesve të popullsisë së krishterë të Shkodrës mbi faktin se Malësia e Gjakovës nuk ka qenë kurrë pjesë e prefekturës së Shkodrës.

shpallur ligji i zgjedhjeve, kleri angazhoi të gjithë pasuesit e vet, që në ditën e zgjedhjeve të votonin kandidatët katolikë.<sup>29</sup>

Kjo tendencë politike, linte të nënkuptohej se, përfaqësuesit e tyre në qeverisje e administratë ishin shmangur, duke krijuar një disbalancim në raportet krahinore e fetare. Në shtypin e kohës, bëhej me dije se, në qarqe katolike, përbërja e qeverisë Vrioni, konsiderohej se mishëronte në vetvete interesat e shtresës konservatore, të trashëguar prej kohës otomane dhe nga pikëpamja fetare, mbizotëronte përkatësia myslimane. Ata mendonin se, shumë personalitete, me një kontribut të admirueshëm përgjatë lëvizjes kombëtare, kishin mbetur jashtë qeverisë, përfshi këtu edhe përfaqësues të Korçës e të Shkodrës. Për të siguruar një përfaqësim sa më të denjë në parlament, e pse jo, edhe në qeverinë e dalë pas zgjedhjeve, në listën e kandidatëve katolikë shkodranë, ishin përfshirë personalitete të shquara. Me këtë synohej sipas tyre, jo vetëm përparimi i kombit, por, edhe sigurimi i të drejtave të kishës e të popullit katolik, deputetët do të kishin një përgjegjësi të rëndë para Zotit, para kombit dhe para historisë.<sup>30</sup> Ky ishte një rast *par excellence* i përzierjes së kishës në politikë dhe sigurisht përbënte një kundërshti të fortë në procesin e ndërtimit të një shteti modern laik dhe me frymë demokratike e kombëtare.

Krahas mospajtimit që ekzistonte midis qeverisë dhe rretheve drejtuese të klerit katolik në Shkodër, ekzistonin edhe kundërshti ndërmjet Tiranës zyrtare dhe drejtuesve të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (KMKK). Kadri Prishtina protestonte, se gjatë vizitës që kishte bërë ministri i Brendshëm në Shkodër në klubin e katolikëve, kishte pranuar që katolikët të nxirrnin 7 deputetë.<sup>31</sup> Hoxha Kadriu, shkruante se, kjo u kishte dhënë guxim katolikëve dhe ata e kishin shtuar numrin e deputetëve që kërkonin nga 7 në 8 deputetë. Po kështu, ai theksonte se Këshilli i Ministrave, kishte shkëputur Kthellën nga Kruja dhe ia kishte bashkuar Shkodrës. Pas këtyre vendimeve, Këshilli i Ministrave, kishte njohur të drejtën e zgjedhjes së 8 deputetëve

<sup>29</sup> “Si duelën deputetët katolikë të Shkodrës”, *Hylli i Dritës*, nr. IV, Shkodër, 1921, f. 179.

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> *AQSH*, F. 442, V. 1921, D. 7, fl. 10. Analizë e Hoxha Kadriut mbi vendimet e qeverisë për nxjerrjen e 8 deputetëve katolikë dhe 4 deputetëve myslimanë në prefekturën e Shkodrës.

katolikë, 4 deputetëve myslimanë e 1 deputeti për Bujanin.<sup>32</sup> Në këtë analizë të H. Kadriut vërtetoheshin shqetësimet e katolikëve, se në Bujan po përfshiheshin zgjedhës të mbetur jashtë kufijve të vitit 1913. Sipas tij, nënprefektura e Bujanit kishte 40.000 frymë, respektivisht në krahinat Krasniqe, Gash, Bytyç, Rekë, Vuthaj, Plavë, Guci, të cilat, sipas tij, duhet të zgjidhnin tre deputetë. Në vijim të analizës së tij, ai e quante të padrejtë vendimin e qeverisë e të Ministrisë së Brendshme për nxjerrjen e 8 deputetëve katolikë dhe polemizonte duke shkruar: “kur frymët e katolikëve qenkan shtue, po myslimanëve a u paska ra kolera”.<sup>33</sup>

Në këtë situatë, KMKK i drejtoi kryeministrin një promemorie ku ankohej për numrin e vogël të përfaqësuesve në Këshillin Kombëtar dhe për faktin se Malësia e Shkodrës nuk kishte asnjë deputet për shkak se nuk kishte paguar taksat shtetërore.<sup>34</sup> Hoxha Kadriu kërkoi nga Mehdi Frashëri të ndërhynte për të korrigjuar numrin e popullsisë së nënprefekturës së Bunajt, Nikaj-Mërturit, Hasit dhe fshatrave të tjerë për shkak se kishte ndikim të drejtpërdrejtë në numrin e përfaqësuesve nga Shqipëria Veriore dhe Kosova.<sup>35</sup>

Por, qeveria vijoi me plotësimin e një kërkesë tjetër të grupit katolik të Shkodrës. Këshilli i Ministrave mori vendimin që, nënprefektura e Bujanit do t'i bënte zgjedhjet e ndara nga Shkodra. Për këtë, Hoxhë Kadriu, e akuzoi qeverinë duke pohuar se qëndrimet e mësipërme provonin që Këshilli i Ministrave, me vendimet kontradiktore, u shndërrua në një pazar.<sup>36</sup> Këtu del i qartë fakti se Hoxhë Kadriu synonte marrjen e deputetëve në Malësinë e Gjakovës, ku grupi kosovar kishte fituar një influencë më të madhe, për shkak të ndikimit të B. Currit dhe frymës nacionaliste që mbizotëronte në këtë zonë.

Prefektura e Shkodrës, ngaqë nuk kishte një statistikë të popullsisë në juridiksionin e saj, kishte krijuar një komision, i cili përbëhej nga anëtarë të Këshillit Administrativ të prefekturës e prej Këshillit të

<sup>32</sup> *Po aty*, fl. 11.

<sup>33</sup> *Po aty*, fl. 12.

<sup>34</sup> *Po aty*, F. 446, V. 1921, D. 69, fl. 1-4. Letër e KMKK-së, për Kryeministrin, Shkodër, 3 prill 1921.

<sup>35</sup> *Po aty*, F. 446, V. 1921, D. 57, fl. 16-21. Letër e Hoxha Kadriut, për Mehdi Frashërin, Shkodër, 17 mars 1921.

<sup>36</sup> *Po aty*, F. 442, V. 1921, D. 7, fl. 13. Akuza ndaj qeverisë nga drejtuesit katolikë të prefekturës së Shkodrës mbi faktin se ajo po bënte pazare me zgjedhjet.

Përlymtores [nën kryesinë e kryetarit të Përlymtores]. Këtij komisioni, iu ngarkua detyra për të caktuar numrin e banorëve të prefekturës e të nënprefekturave. Me gjithë përpjekjet, komisioni nuk mundi ta realizojë këtë detyrë dhe në këto rrethana, Ministria e Punëve të Brendshme u detyrua të mbështetej në statistikën e popullsisë të hartuar nga autoritetet austro-hungareze gjatë Luftës së Parë Botërore. Në bazë të kësaj popullsie, prefekturës së Shkodrës i përkisnin 11 deputetë, prej të cilëve 7 katolikë e 4 myslimanë. Por, kjo nuk u prit mirë nga paria katolike, e cila vendosi bojkotimin e zgjedhjeve, deri sa të vendosej proporcioni 8 me 4, në favor të deputetëve katolikë.

Çështja e numrit të deputetëve të Shkodrës u propagandua gjerësisht në shtypin lokal të kësaj krahine. Kështu, gazeta “Besa Shqyptare”, që u bë zëdhënëse e kërkesave të drejtuesve katolikë, informonte se, të dielën më 20 shkurt 1921, ishte mbledhur populli katolik i Shkodrës te Kisha e Madhe e qytetit, për çështjen e deputetëve, ku mbas disa diskutimesh publike ishte vendosur të kërkoheshin “të drejtat deputore” sipas ligjit për zgjedhjet. Për këtë, ishte marrë vendimi që “me ba obstrukcionizëm” në zgjedhjen e deputetëve deri sa të pranohej prej qeverisë numri i plotë që u përkiste katolikëve në prefekturën e Shkodrës.<sup>37</sup>

Në këtë mënyrë, obstrukcionizmi në zgjedhjet në zonën e prefekturës së Shkodrës, vijoi edhe gjatë muajit mars, nën drejtimin e shoqërisë “E drejta Kombtare” e cila, paraqitej si zëdhënëse e të drejtave të popullit kristian, të prefekturës së Shkodrës.<sup>38</sup> Ky qëndrim i katolikëve shkodranë u kritikua hapur nga Hoxha Kadri Prishtina, i cili hartoi promemorien “Drejt sistemit kantonal” ku shprehej kundër pikëpamjes se raporti i deputetëve në Shkodër duhej të ishte një me dy në favor të popullsisë së krishterë.<sup>39</sup>

Nga ana tjetër, shtypi katolik, vinte në dyshim edhe statistikën austro-hungareze, duke theksuar se ajo kishte shumë gabime e nuk i përgjigjej kryekëput numrit të vërtetë të popullsisë. Theksohej se edhe vetë autoritetet austro-hungareze, duke njohur mangësitë e saj, kishin

---

<sup>37</sup> “Çështja e deputetëve të prefekturës së Shkodrës”, *Besa shqyptare*, Shkodër, nr. 3, 24 Fruer 1921.

<sup>38</sup> “Çështja e Deputetëve në Shkodër”, *po aty*, nr. 5, 10 marc 1921.

<sup>39</sup> *AQSH*, F. 422, V. 1921, D. 7, fl. 1-16. Promemorie e Hoxha Kadri Prishtinës me titull “Drejt sistemit kantonal”, 12 prill 1921.

planifikuar atëherë të hartonin një statistikë tjetër. Gazeta “Besa Shqyptare” theksonte se, qeveria nuk duhej dhe nuk mund ta përdorte statistikën austro-hungareze për prefekturën e Shkodrës, kur ajo nuk e kishte përdorur këtë për prefekturat e tjera.<sup>40</sup> Pas këtij presioni, qeveria u tërhoq. Ministria e Brendshme, njoftoi më 31 mars, se qeveria, duke u mbështetur në statistikën austro-hungareze dhe duke marrë parasysh shtesën e popullsisë prej 5% në tri vitet e fundit, pranonte që në prefekturën e Shkodrës të zgjidheshin 8 deputetë të krishterë, përkundrejt 4 deputetëve myslimanë.<sup>41</sup> Kështu mosmarrëveshjet më në fund u zgjidhën dhe përfaqësuesit e të krishterëve shkodranë siguruan një marrëveshje në mënyrë administrative, pa kaluar në një kryengritje. Kjo ishte e para lëvizje me sfond politik, ku kërkohet zgjidhje në marrëveshje me institucionet shtetërore, siç ishte ministri i Brendshëm, i cili e kishte çështjen në kompetencë për ta zgjidhur.

Pas të gjitha këtyre përpjekjeve, më 12 prill 1921 u njoftua popullata e prefekturës se qeveria e Tiranës i njohu kërkesat e popullsisë së krishterë, duke vendosur që prefektura e Shkodrës të përfaqësohej me 12 deputetë, 8 katolikë e 4 myslimanë. Pas këtij vendimi, kërkohet përfundimi i bojkotit.<sup>42</sup> Për të shkarkuar nga vetja përgjegjësinë e çdo vonese në zhvillimin e zgjedhjeve, “Komiteti për të Drejta Kombëtare”, që vepronte në Shkodër, në një letër drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, më 15 prill 1921, kërkonte të jepej urdhër për nisjen e votimit.<sup>43</sup> Kjo letër nënshkruhej nga personalitetet e komitetit dhe përfaqësuesve politikë të qytetit si: Pashk Ashiku, D. Mark Shllaku, Gjon Çoba, Luigj Thaci dhe P. Troshani.

Situata ishte edhe më e vështirë në jug, ku u shfaqën tendenca edhe më të forta kantonale, të cilat buronin nga mentalitetet e së shkuarës dhe gjithashtu nxiteshin hapur ose në mënyrë të tërthortë nga propaganda dhe politika greke. Këto mentalitete buronin nga thellësitë e sundimit osman dhe nuk pajtoheshin aspak me realitetin e me nevojat dhe perspektivën e

<sup>40</sup> “Çashtja e zgjedhjeve”, *Besa shqyptare*, Shkodër, nr. 5, 10 marc 1921; *po aty*, nr. 6, 17 marc 1921.

<sup>41</sup> “Çashtja e zgjedhjeve të deputetvet mori fund”, *po aty*, nr. 8, 31 marc 1921.

<sup>42</sup> *AQSH*, F 132/A, V. 1921, D. 8, fl. 9. Njoftim i qeverisë së Tiranës mbi plotësimin e kërkesave të popullsisë së krishterë të prefekturës së Shkodrës dhe kërkesën për përfundimin e bojkotit të zgjedhjeve.

<sup>43</sup> *Po aty*, fl. 10.



domosdoshme të stabilizimit të shtetit shqiptar. Këtë fakt e pohonte edhe Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve (LK), i cili në raportin e tij, theksonte kërkesat lidhur me ndarjen elektorale, të cilat synonin t'i shërbenin konservimit të ndarjeve fetare dhe krahinore, duke i ngritur ato në nivelin e kufijve elektorale me perspektivën që të shndërroheshin në mure të larta segregacioni politik, duke shkelmuar dhe gërryer kështu unitetin kombëtar.<sup>44</sup>

Në fakt, në shfaqjen e këtyre kërkesave të rrezikshme kishte një rol të madh dhe të drejtpërdrejtë edhe politika greke, e cila donte që institucionet kombëtare shqiptare, siç ishte edhe ndarja territoriale apo zonat elektorale, të ishin një bombë me sahat për shtetin e ri, të cilën ata të mund ta ndiznin sa herë që t'u duhej.

Në raportin e lartpërmendur të Komisionit Hetimor të LK, thuhej: "Një ankesë e pakicave të krishtera, e cila më duket se ishte e justifikuar, ishte ndarja e sotme e distrikteve elektorale në dëm të tyre".<sup>45</sup> Këtu është fjala për kufijtë e zonave elektorale për të cilat katolikët shkodranë dhe ortodoksët e Korçës donin që të përfshinin gjithë popullsinë katolike dhe ortodokse. Por, nga ana tjetër, raportet midis grupeve të besimeve të ndryshme të popullsisë shqiptare në përfaqësimin e tyre në pushtet, ishin ruajtur, madje duke favorizuar përfaqësimin e popullsisë së krishterë, duke realizuar kështu një diskriminim pozitiv në përfaqësimin e saj në organet shtetërore. Kjo pohohej edhe në raportin e Komisionit Hetimor, por për shkak të bojkotimit masiv të zgjedhjeve nga ortodoksët, fituan një grup nacionalistësh shqiptarë ortodoksë që kishin mbështetjen e asaj pjese të elektoratit që nuk i bojkotoi zgjedhjet. Qarqet greke e interpretuan këtë rezultat se këta ortodoksë nacionalistë shqiptarë nuk përfaqësonin realisht ortodoksët në institucionet shqiptare, duke demonstruar kështu fobinë e tyre ndaj këtyre institucioneve.

Përfaqësimi në një masë më të madhe i popullsisë së krishterë në institucionet kombëtare, ka qenë një veprim i zgjuar për të ndihmuar në forcimin e autoritetit kombëtar dhe në goditjen pak nga pak edhe të barrierave, që ende qëndronin midis popullsisë shqiptare të besimeve të

---

<sup>44</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), Viti (më tej: *V.*) 1923, Dosja (më tej: *D.*) 211, fl. 3-31. Raport i Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve për periudhën 19 dhjetor 1922 - 1 shkurt 1923.

<sup>45</sup> *Po aty*.

ndryshme, me perspektivë eliminimin e këtij kriteri në të ardhmen, një gjë që sot mrekullisht e shohim të realizuar në ndërtimin e institucioneve shqiptare.

Pretendimi se të krishterët e asaj kohe, të zgjedhur në zonat e tyre elektorale, nuk përfaqësonin popullsinë e krishterë, por ishin njerëzit e qeverisë, ishte sa absurd aq edhe antikombëtar, pasi ai bazohej në segregacionin politik fetar dhe i kundërvihet procesit të homogjenizimit dhe unifikimit kombëtar. Në këtë rast “njerëzit e qeverisë” ishin ata nacionalistë shqiptarë të cilët kishin hedhur mënjanë paragjykimet e vjetra të ndarjes fetare dhe i ishin përveshur punës për ndërtimin e institucioneve kombëtare gjithëpërfaqësuese dhe sa më efektive, pa krijuar në to ndarje e fraksione krahinore e fetare.

Edhe ndarja e zonave elektorale ishte një mënyrë tjetër e rëndësishme për të zbehur dallimet dhe përçarjet politike mbi baza fetare, për të cilën Athina po ushtronte presion të madh në të gjitha drejtimet.<sup>46</sup> Kjo ishte mënyra e vetme që institucioni i zgjedhjeve të kishte karakter kombëtar dhe të prodhonte unitet dhe harmoni kombëtare si dhe institucione politike homogjene nga pikëpamja kombëtare.

Në këtë drejtim, shteti shqiptar zgjodhi rrugën më të drejtë që çonte drejt homogjenizimit të tij politik, një rrugë kjo e vështirë që u përshkrua nën peshën e presionit të jashtëm, që vinte nga shtetet fqinje e kryesisht nga Greqia, por edhe si rezultat i presioneve të brendshme që e kishin bazën në prapambetjen e shtresave të caktuara të popullsisë, tek të cilat, përveç rrënjëve të së kaluarës, zinte vend edhe propaganda greke. Presioni grek dhe mendësitë e vjetra përçarëse, ndikuan në një abstenim të një pjese të popullsisë shqiptare ortodokse, në zgjedhjet e para të lira, duke sfiduar përpjekjet për ndërtimin e institucioneve kombëtare në një moment tepër delikat dhe të vështirë.

Sipas raportit të Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve “vetëm pak të krishterë morën pjesë në zgjedhjet për parlamentin e sotëm. Në qytetin e Korçës, me 7000-8000 votues të krishterë, votuan vetëm 200. Ndonëse u zgjodhën tre përfaqësues të krishterë, kjo nuk do të thotë se me të vërtetë ato përfaqësojnë popullin e Korçës. Arsyeja e kësaj greve (obstruksioni) ishte frika se qeveria do të ndërhynte në zgjedhje.” Por,

<sup>46</sup> Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, Tiranë: Kristalina-KH, 2013, f. 329.

nga ana tjetër, vetë Komisioni vlerësonte se “mënyra e protestës ishte jo praktike. Qeveria ka dhënë sigurinë se nuk do të përpiqet të influencojë votën e lirë të popullit në zgjedhjet e pritme dhe duket e sigurt se të krishterët do të marrin pjesë aktive.”<sup>47</sup>

Më 13 shkurt 1921, Koço Kota i drejtoi një memorandum qeverisë në të cilin kërkonte që në jug të vendit të krijohet një administratë e veçantë “autonome”, me parlament të vetin, e cila ta kishte qendrën në Korçë.<sup>48</sup> Ky zhvillim e vuri në vështirësi qeverinë shqiptare dhe nxiti veprimtarinë antishqiptare të shteteve fqinje kundër shtetit shqiptar. Ndërhyrjen greke e nënvizonte edhe raporti vjetor i diplomatit britanik, Harry Eyres, i cili refuzimin e një pjese të madhe të popullsisë së Korçës për të votuar do ta konsideronte si incidentin më të rëndësishëm të ndodhur gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të para politike në Shqipëri.<sup>49</sup>

Duhet nënvizuar fakti se një abstenim kaq i gjerë i popullsisë së krishterë i delegjitimonte përfaqësuesit e zgjedhur në parlament, ndonëse ata ishin patriotë të njohur shqiptarë. Ky fakt është një tregues domethënës i vështirësive që ndeshte procesi politik për ndërtimin e institucioneve kombëtare në këto momente në Shqipëri dhe i gabimit që kishte bërë klasa politike shqiptare duke iu drejtuar zgjedhjeve të para parlamentare në një kohë kur shteti i ri nuk ishte njohur ende në arenën ndërkombëtare. Pavarësisht se Shqipëria e Jugut përbëhej në shumicën dërrmuese të saj nga popullsia shqiptare e të dy besimeve dhe kishte vetëm një pakicë të vogël kombëtare greke, pala greke përfitoi prej saj, ankesat e së cilës u konsideruan të argumentuara nga diplomacia britanike.

Duke e vlerësuar momentin e zgjedhjeve, si të gabuar, përfaqësia britanike, i cilësonte zgjedhjet në Shqipërinë e Jugut [Epirin e Veriut shprehej ajo], si jo në përputhje me ligjin ndërkombëtar, përderisa fati i këtij rajoni nuk ishte përcaktuar ende. Ajo informonte Londrën se: “qeveria shqiptare, në kundërshtim me zakonet ndërkombëtare, ka deklaruar se kjo provincë e përbërë nga grekë në ndjenja, do t’i

---

<sup>47</sup> *AMPJ*, V. 1923, D. 211, fl. 3-31. Raport i Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve për periudhën 19 dhjetor 1922 - 1 shkurt 1923.

<sup>48</sup> B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar ...*, f. 333.

<sup>49</sup> *TNA*, FO 371/7332, fl. 384-394. Raport vjetor për vitin 1921, H.C.A. Eyres, për Marquess Curzon of Kedleston, Durrës, 1 maj 1922.

nënshtrohet këtyre zgjedhjeve. Shoqata e Epirit të Veriut e bazon argumentin e saj në faktin se kjo provincë duhet t'i jepet Greqisë sipas vendimit të marrë nga Këshilli i Lartë në Paris më 13 janar 1920, në të cilin, u njoftua Këshilli për marrëveshjen Tittoni-Venizellos në lidhje me kufijtë e Epirit të Veriut. Edhe pse vendimi i Këshillit i 13 janarit dhe marrëveshja e fshehtë Tittoni-Venizellos nuk do të pranohet lehtë nga Italia, prapë është pa dyshim e vërtetë se këto kufij akoma nuk janë përcaktuar dhe qeveria shqiptare nuk ka të drejtë të zhvillojë zgjedhje në këto provinca.<sup>50</sup>

### **Ballafaqimet politike gjatë fushatës zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve**

Në pjesën tjetër të Shqipërisë zgjedhjet u karakterizuan nga një debat normal politik të përgjithshëm me përmbajtje racionale, ku inteligjenca progresive dhe shtresa konservatore u ballafaquan ndërmjet tyre. Në Elbasan, u zhvillua një debat i fortë, i cili gjeti një pasqyrim të gjerë në gazetën “Shkumbini”, gjë që na mundëson të krijojmë një panoramë të ballafaqimit elektorale në këtë qark. Sipas gazetës, grupet e përfshira në zgjedhje ishin: “paria, borgjezia, nacionalistët dhe katundarët”, por vetëm tre shtresat e para, do të kishin përfaqësuesit e tyre. Dukshëm evidentohet përkrahja që gazeta i bënte grupimit nacionalist.<sup>51</sup> Në fakt, në këtë qytet pati një konkurrencë elektorale interesante për shkak se aty garonin dy grupime në krye të të cilave qëndronin dy personalitetet kryesore të Elbasanit, Shefqet Vërlaci e Aqif Pashë Elbasani.<sup>52</sup> I gjithë procesi elektorale u pasqyrua në Gazetën “Shkumbini”, që nga debati për zgjedhjet e deri te publikimi i emrave të zgjedhësve të dytë, e më në fund të emrave të deputetëve të zgjedhur. Në përfundim, në trevën e Elbasanit, zgjedhjet e pranverës të vitit 1921, i fitoi me shumicë grupi i Shefqet Vërlacit.<sup>53</sup>

<sup>50</sup> *Po aty*, FO 371/5275, fl. 465-466. Zgjedhjet në Epirin e Veriut, 5 shkurt 1921.

<sup>51</sup> “Analizë mbi zgjedhjet”, *Gazeta Shkumbini*, nr. 9, Elbasan, 11 mars 1921, f. 1.

<sup>52</sup> Rudina Mita (Todri), *Elbasani, Jeta Politike në vitet 1920-1924*, Tiranë: Ilar, 2007, f. 138.

<sup>53</sup> *Po aty*, f. 144.

Pas Shkodrës dhe Elbasanit, i një rëndësie të veçantë ishte debati politik i zhvilluar në një qendër tjetër të zhvillimeve politike, në Gjirokastrë. Debati i zhvilluar në këtë qytet i dha një tjetër impuls ballafaqimit të përgjithshëm elektoral. Në Gjirokastrë turi i parë i zgjedhjeve përfundoi në fillim të marsit 1921, kurse raundi tjetër u zhvillua në gjysmën e dytë të marsit, në katër qendra, Gjirokastrë, Delvinë, Përmet e Tepelenë. Zgjedhjet parlamentare në prefekturën e Gjirokastrës përfunduan më 27 mars 1921 dhe grupi popullor i fitoi të 11 deputetët.<sup>54</sup>

Një problem tjetër u krijua nga pamundësia e zhvillimit të zgjedhjeve të rregullta parlamentare në prefekturën e Drinit, e cila ishte pushtuar pjesërisht prej forcave serbe. Në këto zgjedhje parlamentare, qeveria e Iliaz Vrionit, i kishte njohur nënprefekturës së Tropojës të drejtën e zgjedhjes së dy deputetëve, ku Bajram Curri me ndikimin e tij nxori deputet për “Përparimtarët” Mustafa Krujën dhe për “Popullorët” Rexhep Mitrovicën.<sup>55</sup>

Në procesin e ndërtimit të Parlamentit të ri Shqiptar që do të dilte nga zgjedhjet e vitit 1921 kemi një rast interesant përfaqësimi. Në të u përfaqësua edhe diaspora shqiptare e Amerikës me një përfaqësues të organizatës më të madhe të saj, Federatës Panshqiptare “Vatra”.<sup>56</sup> Menjëherë pas kërkesës së qeverisë shqiptare për caktimin e përfaqësuesit të “Vatrës” në Parlamentin Shqiptar dhe propozimin prej saj të Fan Nolit, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin përkatës mbi pranimin e tij, si deputet në Parlamentin Shqiptar. Në telegramin e Kryetarit të Federatës “Vatra”, thuhej se, “si depytet i asaj shoqërije për në Parlamentin kombëtar asht zgjedhe Imzot Fan Noli, i cili massi asht ndodhun n’Amerikë shumë kohë e ma në funt si përfaqësuesi i Shtetit

<sup>54</sup> Bektash Mema, Ajet Shahu, *Prefektura e Gjirokastrës 1920-1924*, Berat: Jonalda, 2001, f. 143.

<sup>55</sup> Tafil Boletini, *Kujtime, "Pranë Isa Boletinit" (1892-1916) & "Përballë sfidave të kohës" (1916-1963)*, përgatiti për botim Marenglen Verli, Tiranë: Botimpex, 2003, f. 315.

<sup>56</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1921, D. 25, fl. 2. Telegram i Kryeministrit Iljaz Vrioni, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbi caktimin e përfaqësuesit të “Vatrës” në Parlamentin Shqiptar.

Shqiptar pranë Lidhjes së Kombevet në Genevë, Këshilla nuk sheh nonji ndalim mbi mos pranimin e tij”.<sup>57</sup>

Zgjedhjet u deklaruan të përfunduara në rang kombëtar, me përjashtim të Shkodrës, ku u zhvilluan më vonë për arsyet e lartpërmendura. Në zgjedhjet e vitit 1921 Avni Rustemi u zgjodh përfaqësues i popullit të Kosovës.<sup>58</sup>

Përfaqësuesit britanikë në Tiranë evidentonin faktin se në parlamentin e ri nuk ishin zgjedhur grekë, vllahë, esadistë, por ishin zgjedhur disa proitalianë që mendonin se qeveria në detyrë nuk do të rimodelohej.<sup>59</sup> Ata raportonin edhe qetësinë në të cilën ishin zhvilluar zgjedhjet, duke na dhënë edhe këtë tablo interesante të rezultateve të tyre: “70 nga deputetët janë zgjedhur pa ndonjë incident, ndonëse një numër i madh i të krishterëve në Korçë nuk kanë votuar për shkak të intrigave të kryepeshkopit grek. Nacionalistët e vërtetë patriotë të cilët kundërshtonin çdo lloj influence të huaj mund të numërojnë rreth 30 deputetë. Asnjë program nuk u vu përpara, asnjë kriter për pjesëmarrjen në parti dhe deputetët u zgjodhën sipas aftësive personale ose sipas mbështetjes që ato gëzonin.”<sup>60</sup>

Informacionet e mësipërme përforcoheshin edhe në raportin e datës 18 prill, kur pohonin se zgjedhjet kishin kaluar pa shumë fërkime nga sa ishte pritur. Regjentët dhe shumica e deputetëve kishin pranuar që “Dhoma” të ishte një parlament i thjeshtë dhe se dukej e vështirë që forma e përkohshme e qeverisjes të ndryshohej apo të tentohej për një kushtetutë të re.<sup>61</sup>

Më 22 prill, britaniku Eyres, do të bënte një bilanc më të plotë, i cili konfirmonte të dhënat që ai kishte njoftuar më parë. Ai njoftonte lordin Curzon se: “Zgjedhjet në përgjithësi kaluan pa shumë probleme. Është e vërtetë se në qytetin e Korçës shumica e popullsisë ortodokse nuk mori

<sup>57</sup> *Po aty*, fl. 4. Vendim i Këshillës Ministrore, mbi pranimin e Fan Nolit si deputet në Parlamentin Shqiptar.

<sup>58</sup> *Po aty*, F. 417, V. 1921, D. 35, fl. 9. Letër e Qerim Gurabardhit, për Avni Rustemin, Tiranë, 1921.

<sup>59</sup> *TNA*, FO 371/5726, fl. 667. Telegram i Mr. Temperley, dërguar FO, 7 prill 1921.

<sup>60</sup> *Po aty*, FO 371/5726, fl. 723-724. Telegram i Eyres mbi zgjedhjet në Shqipëri, 21 prill 1921.

<sup>61</sup> *Po aty*, FO 371/5726, fl. 769. Telegram i Eyres mbi situatën politike në Shqipëri, 22 prill 1921.

pjesë në votime, të nxitur nga peshkopi i Greqisë në Durrës, me synimin për të treguar se popullsia e krishterë refuzonte të kryente ndonjë veprim, i cili do të shprehte dëshirën për bashkimin me Shqipërinë dhe nga kryetari i bashkisë së Korçës, i cili ishte shtytësi kryesor i manifestimit të pavarësisë, të përmendur në telegramin e mëparshëm. Ministri i Brendshëm, Mehdi Beu, i cili ishte mbështetës i Ahmet Zogut, ndërhyri në zgjedhjet në Elbasan, duke hequr nënprefektët dhe në zgjedhjet e Dibrës, duke lejuar 85 zgjedhës të dytë të emërohen nga fshatrat, të cilat sipas popullsisë duhet të emëronin vetëm 27. Drejtuesit kryesorë të Dibrës, të udhëhequr nga Elez Isufi, zgjodhën 44 zgjedhës mbështetës të Ahmet Zogut”.<sup>62</sup>

Faza e dytë, ishte ajo e certifikimit të rezultateve, nëpërmjet një komisioni parlamentar të ngritur enkas për këtë qëllim. Ky komision, më datën 5 maj 1921, vendosi të shqyrtojë emrat e deputetëve të secilës prefekturë sipas rendit alfabetik, duke filluar me Beratin.<sup>63</sup> Ky komision, megjithëse në shumicën e rasteve i konfirmoi emrat e dalë nga zgjedhjet, për prefekturën e Drinit pati mosmarrëveshje. Imzot Fan Noli, propozoi që për problemet e hasura të ndërmerrej një hetim parlamentar dhe në votimin përkatës të mos merrnin pjesë deputetët e Drinit, pasi nuk ishte e drejtë që ata të ishin edhe të gjykuar edhe gjykues. Por, ky propozim u rrëzua me 16 vota, kundrejt 10 votave që e përkrahën këtë ide. Në përfundim të shqyrtimit të Komisionit u konfirmuan edhe deputetët e Drinit. Pas një procesi të vonuar, edhe Shkodra iu bashkëngjiti Parlamentit Shqiptar me përfaqësuesit e vet, të cilët ishin ndër njerëzit më të shquar në vend.<sup>64</sup>

Duke bërë bilancin përfundimtar të zgjedhjeve, përfaqësuesi britanik Eyres, njoftonte Sekretarin britanik Curzon, se numri 77 i deputetëve do të shkonte në 79, kur Himara të zgjidhte 2 deputetët e saj. Nga këto 28 ishin të krishterë (8 katolikë dhe 20 ortodoksë).<sup>65</sup> Por, Himara i bojkoi

<sup>62</sup> *Po aty*, FO 371/5726, fl. 772. Telegram i Eyres dërguar Earl Cuzon, 22 prill 1921.

<sup>63</sup> *AQSH*, F. 146, V. 1921, D. 2, fl. 243-246. Raport i komisionit parlamentar “B”, i formuar për shqyrtimin e zgjedhjeve të anëtarëve të komisionit parlamentar “A”, me kryetar Ibrahim Xhindin, mbi ligjshmërinë e zgjedhjes së deputetëve të Gjirokastrës, Vlorës, Korçës, “Vatrës”, Beratit, Elbasanit, Matit dhe deputetëve të Drinit.

<sup>64</sup> *Po aty*, fl. 262.

<sup>65</sup> *TNA*, FO 371/5728, fl. 554. Telegram i Eyres për Earl Curzon mbi zgjedhjet dhe partitë politike në Shqipëri, 5 korrik 1921.

masivisht zgjedhjet. Pjesëmarrja e himarjotëve në votime ishte shumë e pakët. Nga 8000 vetë, votuan vetëm 50. Për këtë arsye qeveria i shpalli zgjedhjet e Himarës jolegale.<sup>66</sup>

Në një raport tjetër, Eyres fliste se parlamenti do të kompletohej me kthimin e dy përfaqësuesve të Himarës. Ai shkruante se, himarjotët “kanë qenë një komunitet i privilegjuar nën regjimin turk. Krahina ishte një vend i mirë për intrigat greke dhe strehim për të gjithë kriminelët e jugut të Shqipërisë.” Ai informonte se himarjotët, në një telegram dërguar qeverisë shqiptare, kërkonin “kontribute fikse në vend të taksave; një drejtues xhandarmërie dhe një gjyqtar të krishterë; shërbimi ushtarak të limitohet në jug të vendit në kohë paqeje dhe pa limit në kohë lufte; gjuhët shqipe dhe greke në shkolla; dy deputetë të ktheheshin në Parlament”.<sup>67</sup>

Në përfundim të këtij ballafaqimi elektoral vlen të theksohet se u tregua një kujdes i veçantë për dokumentimin e procesit, duke mbajtur procesverbale të rregullta, megjithëse këto zgjedhje ishin përvoja e parë për vendin. Rezultatet faktuan mbizotërimin në jetën politike të figurave konservatore, të cilët renditeshin në krye të listave të deputetëve të zgjedhur.

Për kushtet e Shqipërisë së asaj kohe rregullsia në zgjedhje ishte mbresëlënëse. Ky është një fakt historik që meriton të analizohet gjerësisht. Sigurisht në mendjen e çdo itelektuali lind vetvetiu një pyetje themelore: Si ishte e mundur që në atë kohë dhe me atë nivel të politikës dhe shoqërisë shqiptare të zhvilloheshin zgjedhje të tilla, rregullsinë e të cilave ende nuk e kemi arritur në disa prej proceseve zgjedhore të zhvilluara gjatë këtyre tre dekadave të tranzicionit postkomunist. Mendojmë se kjo lidhet veçanërisht me faktin se në atë kohë palët ende nuk ishin shumë të polarizuara dhe nuk patën vullnet për të manipuluar zgjedhjet.

Surprizën e këndshme se zgjedhjet ishin mbajtur në mënyrë më të rregullt se sa pritej prej shoqërisë shqiptare, e shfaqte një vit më vonë, përfaqësuesi britanik, Eyres, i cili i bënte këtë përshkrim sintetik procesit zgjedhor të vitit 1921: “Duke pasur parasysh se këto ishin zgjedhjet e

<sup>66</sup> B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar ...*, f. 425-426.

<sup>67</sup> TNA, FO 371/7332, fl. 384-394. Raport vjetor për vitin 1921, H.C.A. Eyres, për Marquess Curzon of Kedleston, Durrës, 1 maj 1922.



para politike në Shqipëri, ato u zhvilluan me më pak influencë dhe me më tepër paanësi sesa ishte pritur. Pati abuzime nga zyrtarët dhe nga bejlerët me influencë, por asgjë e ndodhur nuk ka rëndësinë e një ngjarjeje për t'u shënuar. Incidenti më i rëndësishëm ishte refuzimi për të votuar, i një pjese të madhe të popullsisë së Korçës". Sipas tij, ky refuzim ishte rezultat i dy shkaqeve: "Për shkak të propagandës greke, e cila trumbetonte se pjesëmarrja në zgjedhje do të thoshte njohja e qeverisë shqiptare, e cila do të dobësonte pretendimet greke në Epir; dhe përpjekjet e një Partie autonome".<sup>68</sup> Ai kishte parasysh këtu grupin e politikanëve ortodoksë korçarë i njohur ndryshe si "grupi i memorandumistëve".

Raporti i Eyres ka një rëndësi të veçantë sepse na jep një analizë të plotë për fuqinë dhe profilin politik të dy partive kryesore në parlament, madje duke dhënë një dëshmi interesante edhe për evoluimin e qëndrimeve të tyre politike pas konstituimit të parlamentit. Ai pohonte: "U formua një Dhomë me 79 deputetë të cilët ishin pjesë e 'Partisë Progresive' dhe 'Popullore'. Qeveria ishte e mbështetur nga 'Partia Progresive', e cila kishte një shumicë të vogël në Parlament. Diferenca aktuale në qëllime dhe objektiva mes dy partive nuk është e dukshme, por u bë e tillë më vonë, kur 'Partia Popullore' ju kundërvu bejlerëve dhe ishte e vendosur të luftonte me çdo mënyrë kundër sundimit feudal të tyre."<sup>69</sup>

Në këto zgjedhje pati kërkesa dhe ankesa, nga grupe të ndryshme, gjë që dëshmon funksionalitetin e institucioneve dhe krijimin e një mentaliteti të ri të shqiptarëve ndaj tyre. Në këtë kuadër, veçojmë kërkesën e paraqitur nga kryetari i shoqërisë "Vëllazëria Çame", Asaf Çami, i cili i kërkonte Kryesisë së Parlamentit, më 21 maj 1921, pranimin e një deputeti çam në Parlamentin Shqiptar. Nëpërmjet kësaj kërkesë synohej përfaqësimi i popullit çam, i katundit Janjevë, që mbante Greqia jashtë vendimit të Konferencës së Londrës dhe emigrantëve çamë të përhapur në Shqipëri. Si shembull për këtë, merrej politika e ndjekur ndaj

---

<sup>68</sup> *Po aty.*

<sup>69</sup> *Po aty.*

dibranëve e kosovarëve.<sup>70</sup> Një ankesë iu adresua qeverisë nga Gjirokastra për parregullsi të zgjedhjeve. Vetëkuptohet se fitorja e thellë e “popullorëve” i kishte revoltuar kundërshtarët e tyre.

Në zgjedhjet e vitit 1921 u evidentuan edhe ndërhyrjet e huaja. Përveç ndërhyrjes së Greqisë, e cila nxiti bojkotimin e zgjedhjeve në Shqipërinë e Jugut, ndërhyrje pati edhe nga Italia. Legata italiane mbikëqyri me kujdes procesin zgjedhor dhe mbështeti krahun italo-fil të kandidatëve për deputetë. Kjo ndërhyrje ishte një nga shkaqet e klimës konfliktuale që dominoi arenën politike shqiptare.<sup>71</sup> Madje, më vonë legata italiane do t'i kërkonte zyrtarisht qeverisë shqiptare që në diskutimet parlamentare të caktonte si reporter Ndoc Sheldinë. Kjo kërkesë do të ngjallte pakënaqësinë e Ministrisë së Jashtme, e cila kërkonte nga organet policore ta mbikëqyrnin vazhdimisht.<sup>72</sup> Zgjedhjet u zhvilluan gjatë muajit mars dhe prill. Por, edhe pse duhet të përfundonin në fillim të prillit, mosmarrëveshjet mes myslimanëve dhe të krishterëve të Shkodrës, penguan kompletimin e Dhomës së Deputetëve deri më 25 qershor.

Më 21 prill 1921, u mbledh në Tiranë Parlamenti i parë në historinë e shtetit shqiptar, një parlament legjitim i dalë nga zhvillimi i zgjedhjeve. Në asnjë nga botimet politike dhe historike të asaj periudhe nuk ka rezultate të sakta të votave dhe të vendeve që mori secila forcë politike, por të gjithë autorët e studiuesit pranojnë se, grupi konservator fitoi shumicën e deputetëve. Një pjesë e vendeve në parlament u fituan nga kandidatë të tjerë, të cilët, më pas, u bënë pjesë e aleancave për pushtet.

Përfundimi i zgjedhjeve nuk solli stabilitetin e kërkuar politik në vend. Një pjesë e krahinave, sidomos e komuniteteve të ndryshme u ndien të mënjanuara nga zgjedhjet ose të pakënaqura me rezultatin e tyre. Kjo bëri që fillimi i jetës parlamentare të shoqërohej me rritjen e tensioneve politike në vend dhe me rrezikimin e stabilitetit të qeverisjes. Për rrjedhojë, brenda gjashtë muajve që pasuan zgjedhjet e prillit 1921, u

<sup>70</sup> *AQSH*, F. 146, V. 1921, D. 2, fl. 250. Kërkesë e përfaqësuesit të popullsisë çame dhe të kryetarit të shoqërisë “Vllazëria Çame, qendra e Atdheut”, Asaf Çami, drejtuar kryetarit të parlamentit.

<sup>71</sup> *Po aty*, F. 163, V. 1921, D. 3, fl. 1-32. Raporte të legatës italiane, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Durrës, 3 mars 1921-29 tetor 1921.

<sup>72</sup> *Po aty*, F. 152, V. 1921, D. 298, fl. 1-38. Letër e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Tiranë, 29 gusht 1921.

ndërruan shumë qeveri, secila e imponuar nga presionet dhe interesat e grupeve të ndryshme politike, ekonomike dhe ushtarake në parlament dhe jashtë tij.<sup>73</sup>

### **Vlerësimet e zgjedhjeve nga shtypi i kohës dhe historiografia shqiptare**

Historiografia e periudhës komuniste, e ka parë në një prizëm klasor dhe tendencioz zhvillimin e zgjedhjeve të para parlamentare në Shqipëri. Sipas studiuesit të historisë së institucioneve të kësaj kohe, Gramoz Hysit, ndarja e dy rrymave kundërshtarë dhe lufta e hapët politike midis tyre gjatë fushatës së zgjedhjeve që filloi menjëherë pas dorëheqjes së qeverisë dhe shpërndarjes së Këshillit Kombëtar të zgjedhur në Kongresin e Lushnjës, lidhej me vetë kontradiktat në gjirin e shoqërisë së atëhershme. Sipas tij, fushata e zgjedhjeve shënonte shfaqjen e hapët dhe me një forcë të veçantë të këtyre kontradiktave. Por, ajo ndihmoi edhe në përcaktimin e një ndarjeje më të qartë midis dy rrymave kundërshtarë si dhe në rritjen e mëtejshme të veprimtarisë së tyre si forca luftuese të kohës. Dy rrymat kundërshtarë të atëhershme u vunë në ballafaqim të hapët me njëra-tjetrën gjatë fushatës së zgjedhjeve për çështje të rëndësishme të kësaj fushate: së pari, për natyrën juridike të organit që do të zgjidhej; së dyti, për ligjin mbi bazën e të cilit do të bëheshin zgjedhjet, dhe së treti, për vetë zhvillimin e këtyre zgjedhjeve.<sup>74</sup>

Studiuesit Gramoz Hysi, Luan Omari, Arben Puto dhe në tërësi historiografia e mëparshme, e kanë vlerësuar negativisht kryerjen e zgjedhjeve për Këshillin Kombëtar dhe jo për Asamblenë Kushtetuese.<sup>75</sup> Hysi pohonte se, ndërsa në vendimin e qeverisë së S. Delvinës të po asaj dite kur paraqitej dorëheqja e saj shprehej qartë ideja për zgjedhjen e Asamblesë Kushtetuese, përkundrazi qeveria pasuese e Vrionit e fshiu atë dhe e zëvendësoi me idenë e zgjedhjes së një Këshilli tjetër Kombëtar.

<sup>73</sup> A. Krasniqi, *Partitë politike në Shqipëri...*, f. 57-58.

<sup>74</sup> Gramoz Hysi, *Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-1924*, Universiteti Shtetëror, Tiranë: 1988, f. 85.

<sup>75</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 315-316; L. Omari, *Sistemi Parlamentar...*, f. 174-175; *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. III, f. 178-179.

Sipas tij, ideja e dytë u shoqërua edhe me veprimet e mbrojtësve të saj për shpërndarjen e menjëhershme të Këshillit Kombëtar të atëhershëm, ku do të shqyrtohej dhe do të aprovohej ligji përkatës i zgjedhjeve.

Më tej, ai pohon se qëllimi që ndiqej me ndryshimin e karakterit të zgjedhjeve dhe me shpërndarjen e Këshillit Kombëtar ishte i qartë për forcat përparimtare, prandaj ato që në fillim kundërshtuan hapur dhe u përpoqën të kundërvepronin ndaj sulmit të krahut reaksionar. Sipas Kongresit të Lushnjës, vendin e Këshillit Kombëtar të zgjedhur prej tij duhej ta zinte vetëm Asambleja Kushtetuese. Në qoftë se qeveria propozonte për zgjedhje, këtë do ta vendoste Këshilli Kombëtar para të cilit shtroheshin vetëm dy mundësi: të bëheshin zgjedhje për Asambleshë Kushtetuese ose të vazhdonte vetë ai të kryente funksionet e ngarkuara, ashtu siç ishte angazhuar para Kongresit, delegatët e të cilit qenë edhe shumica e anëtarëve të këtij organi të zgjedhur në Lushnjë. Pra, në bazë të vendimeve të Kongresit të Lushnjës nuk shtrohej mundësia e tretë, ajo e zgjedhjes së një Këshilli Kombëtar tjetër.<sup>76</sup> Kundërshtimet e forcave përparimtare nuk arritën të pengonin veprimet e krahut tjetër për zgjedhjet e një Këshilli Kombëtar të ri, në vend të Asamblesë Kushtetuese.

Çështja e dytë, ishte ajo mbi përmbajtjen e ligjit të zgjedhjeve, që u shpall më 5 dhjetor 1920. Me shpalljen e tij bëhej fakt i kryer përcaktimi i mënyrës se si do të zhvilloheshin zgjedhjet e ardhshme dhe për më tepër, vendosej fillimi i shpejtë i tyre. Dy javë pas daljes së ligjit duhej të përfundonte votimi për zgjedhësit e dytë. Forcat përparimtare nuk u pajtuan aspak me përmbajtjen antidemokratike të ligjit të zgjedhjeve dhe nuk lanë rast pa e demaskuar atë, as më vonë, me qëllim që të mos përsëritej sistemi i tij në zgjedhjet e ardhshme. Hysi mendonte se karakteri antidemokratik i ligjit të zgjedhjeve dukej që me vënien e hapët dhe të drejtpërdrejtë të zgjedhjeve nën kontrollin e plotë të qeverisë dhe të organeve të saj në bazë.<sup>77</sup>

Këto komente nuk marrin aspak parasysh faktin se, kriza brenda Këshillit Kombëtar u shkaktua më së shumti për arsye të ambicieve personale dhe mbi të gjitha në një kohë kur nuk mund të thirrej një Asamble Kushtetuese, pasi pozita ndërkombëtare dhe kufijtë e shtetit

<sup>76</sup> G. Hysi, *Organizimi i shtetit shqiptar ...*, f. 86-87.

<sup>77</sup> *Po aty*, f. 90-91.

shqiptar nuk ishin përcaktuar ende. Kështu, kriza u shkaktua në kundërshtim me marrëveshjen e Kongresit të Lushnjës dhe në një kohë tepër kritike dhe të rrezikshme për Shqipërinë.

Po ashtu edhe për karakterin e ligjit të zgjedhjeve, mbahet një qëndrim kritik, i nisur nga pozita ideologjike dhe nuk studiohet e analizohet ai në kontekstin shqiptar të asaj kohe dhe në përputhje me mundësitë e shoqërisë shqiptare në atë periudhë. Sipas studiuesve Luan Omari dhe Arben Puto parimet anakronike të sistemit zgjedhor përcaktuan edhe përbërjen e parlamentit. Autorët e lartpërmendur venë në dukje se zgjedhjet që u bënë në pranverën e vitit 1921, dhanë një rezultat në favor të rrymës konservatore. Nga 78 deputetët “shumica shprehte interesat e bejlerëve, pra vazhdimin e rendit feudal, ashtu siç kishte mbetur që nga koha e Turqisë.”<sup>78</sup>

Ndërkohë ka edhe studiues të tjerë të cilët i kanë vlerësuar më objektivisht zgjedhjet politike të vitit 1921. Sipas studiuesit Afrim Krasniqi, megjithëse me mungesë strukturash dhe programesh të qarta, individët në krye të partive u përpoqën të vënë në dispozicion të zgjedhjeve të gjitha kapacitetet e tyre politike, financiare dhe lidhjet personale. Sipas tij, Parlamenti i parë në historinë e shtetit shqiptar, ishte një parlament legjitim dhe i zgjedhur në mënyrë demokratike.<sup>79</sup>

Qëndrime kritike në historiografi kanë qenë për censusin e zgjedhjes deputet vetëm të atyre që dinin me shkrim gjuhën shqipe, pasi kështu përjashtoheshin të varfrit; për përcaktimin që votuesi të shkruante vetë ose me ndihmën e dikujt emrin e deputetit dhe për sistemin dy shkallësh.<sup>80</sup> Por, duhet theksuar se, prej këtyre autorëve, asnjëherë nuk është analizuar çështja në prizmin e mundësive kulturore, infrastrukturore dhe institucionale që kishte atëherë Shqipëria, për të zbatuar një sistem të drejtpërdrejtë elektoral.

Mendojmë që pavarësisht se sistemi i votimit me dy shkallë nuk është një sistem i përparuar votimi, ai ishte më i përshtatshëm në kushtet e Shqipërisë për shkak të disa faktorëve: *Së pari*, për shkak të nivelit

<sup>78</sup> A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 315-316; L. Omari, *Sistemi Parlamentar...*, f. 174-175; G. Hysi, *Organizimi i shtetit shqiptar ...*, f. 92-95.

<sup>79</sup> A. Krasniqi, *Partitë politike në Shqipëri...*, f. 55-58.

<sup>80</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. III, f. 178-179; A. Puto, *Shqipëria politike ...*, f. 316.

arsimor të votuesve, ku mbi 95% e popullsisë ishte analfabete; *së dyti*, për shkak të nivelit kulturor dhe mungesës së theksuar të përvojës politike, veçanërisht të fshatarësisë shqiptare që përbënte shumicën dërrmuese të votuesve dhe, *së treti*, për shkak të mungesës së theksuar të traditave demokratike në popullsinë shqiptare, institucionet e përgjithësisht në shtetin e ri shqiptar dhe për shkak të traditës së mëparshme osmane, kur zgjedhjet ishin zhvilluar gjithmonë me dy shkallë.

### *S u m m a r y*

#### THE FIRST POLITICAL ELECTIONS IN ALBANIA (APRIL 1921)

The first election, nonetheless were kept in a very unsuitable time for Albania, and would create the first true Albanian parliament, elected by free political elections. However, the Albanian political class still has not make it own this essential law of the democratic governance. It was far away from the spirit and soul of the debate development and political struggle within the framework of the parliament and constitutional norms limits.

At the eve of first election juxtaposition, was observed a rapid political development, were formed the first political groups and affirmed a relatively qualitative press, through which, were manifested political ideas and platforms. This political qualitative step, was coming after the creation of an inner security and from the efforts to realize the political philosophy of Lushnja's Congress. In these conditions, were intensified the efforts to keep a regular election process, that in those conditions was an important development. Except other things, this gave to Albania a positive image in the eyes of the skeptical westerners, and also served to the Albanian politics, because the electoral competition would bring a confrontation of ideas between the political forces. The new election for the Albanian Parliament gave the possibility to the political forces, to do for the first time, a competitive campaign.